



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2018

V E N D I M

Nr. 69, Datë 16/03/2018

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 12, datë 19.01.2018, e Shoqërisë “La Petrolifera Italo-Albanese” SH.A., ku pretendohet për diskriminim, nga ana e Inspektoriatit Shtetëror Teknik dhe Industrial.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

Mbështetur në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, Shoqëria “La Petrolifera Italo-Albanese” SH.A., pretendon diskriminim¹ nga ana e Inspektoriatit Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI). Ky diskriminim lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me shkresën nr. 8795/1, datë 15.12.2017, të dërguar nga ana e këtij institucioni, Degës Doganore Vlorë. Nëpërmjet kësaj shkrese, Dega Doganore Vlorë duhet të kryejë veprime, në lidhje me produktet e shoqërisë ankuese, veprime të cilat ISHTI, nuk i ka kërkuar të kryhen më parë nga degët e tjera doganore, për produktet e shoqërive të tjera, në të njëjtat rrethana. La petrolifera Italo-Albanese sqaron se diskriminimi i saj nga ISHTI, ka ardhur si pasojë e zbatimit të pabarabartë të ligjit nga ana e këtij institucioni për shoqërinë ankuese, në raport me subjekte të tjera që kryejnë të njëjtin aktivitet.

¹ Nuk është përcaktuar asnjë shkak për diskriminimin e pretenduar.